

Me 24 Nëntor 2013 mbahet referendumi gjithë-popullor në nivel të konfederatës, me ç'rast populli duhet të deklarohet në lidhje me tre çështje. Komuniteti Shqiptar i Gjenevës, në pajtim me Statutin e vet, neni 5, në mbledhjet e kryesisë të mbajtur me 07.06.2013. dhe 13.09.2013. ka vendosur të pozicionohet në lidhje me këto çështje si vijon:

### **1. Për pikën e parë nuk deklarohet;**

Pika e parë ka të bëj me pyetjen rreth pagës minimale, sikurse dhe me raportin ndërmjet pagës minimale dhe asaj maksimale. Në kantonin e Gjenevës, sikurse edhe në mbarë Zvicrën, ka disa qindra ndërmarrje private me pronarë nga komuniteti ynë dhe këta pronar nuk janë të interesuar që kjo pagë minimale të përcaktohet, kurse ata me paga të ulëta mendojnë ndryshe. Prandaj Kryesia e KShGj-së nuk është deklaruar. Mbetet që çdokush të votoj sipas interesave vetjake.

### **2. Për pikën e dytë deklarohet "PO";**

Pika e dytë ka të bëj me pyetjen se a duhet zbritur nga tatimi shumën e parave që shpenzohen për kujdesin e fëmijëve edhe për ato familje që vet kujdesen për fëmijët e tyre. Gjer me tani zbritja është bërë vetëm për ato familje që kanë paguar çerdhe ose persona të tretë për kujdesin ndaj fëmijëve të tyre. Duke marrë parasysh se shumica e familjeve shqiptare vet kujdesen për fëmijët e tyre, Kryesia e KShGj mendon se duhet votuar për këtë ndryshim. Në materialin shpjegues për referendum në faqen 15 shkruan se "kjo iniciativë favorizon familjet tradicionale që vet kujdesen për fëmijët e tyre". Pa dyshim, se familjet shqiptare në shumicën e rasteve janë të tilla.

### **3. Për pikën e tretë deklarohet "JO";**

Pika e tretë është e qartë për të gjithë dhe ka të bëj me pyetjen se a jeni për shtrenjtimin e vinjetës për auto-udhë nga 40fr në 100fr në vit. Kryesia e KShGj mendon se duhet votuar kundër. Jo pse jemi kundër ndërtimit të rrugëve të reja, por pse me këtë ngritje nuk sigurohet ndonjë fond i mjaftueshëm për ndërtimin e tyre; me këtë rritje nuk mund të shmangen as tollovitë në rrugë dhe se qeveria qendrore planifikon rritje të çmimit të karburanteve (për më shumë informacione dhe sqarime vizitoni sajtin e tcs në këtë lidhje <http://www.tcs.ch/fr/le-club/politique/dossiers-politiques/vignette-autoroutiere.php>).

Për më shumë, disa nga komuniteti ynë, ata që nuk kanë shtetësi zvicerane, edhe kështu janë të penalizuar duke paguar sigurimin e veturave me çmim më të lartë se të tjerët; të gjithë duhet të paguajnë sigurimin shtesë kur shkojnë në Kosovë, ashtu që shpenzimet për vetura po rriten edhe më shumë. Duke pas parasysh se shumica nga komuniteti ynë kanë të ardhura modeste, çmimi për mbajtjen e veturave po bëhet i papërballueshëm.

Qëndrimi ynë në lidhje me këto çështje nuk e obligon askënd të votoj sipas sugjerimit tonë.

Kryesia e Komunitetit Shqiptar - Gjenevë